



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GRACANICA

Numri i lëndës: 2023:249277
Datë: 03.12.2024
Numri i dokumentit: 06540528

K.nr.451/2023

GJYKATA - THEMELORE - PRISHTINË-DEGA NË GRAQANICË - DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES, sipas Gjyqtarit Rustem Begolli, me pjesëmarrjen e zyrtarës ligjore Blerta Bekteshi, në lëndën e kundërvajtjes kundër te pandehurit: **B. Sh. Xh.**, duke vendosur sipas inicimit te procedurës se kundërvajtjes nga Policia, kundër te lartcekurit për kundërvajtje drejtimi i Mjetit pa fituar të drejtën për patentë shofer, përcaktuar me nenin 231 paragrafi 5 sanksionuar me nenin 231 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 05/L-088 e ne lidhje me Ligjin Nr. 06/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-088 për rregullat e trafikut rrugor i cili përcakton në nenin 19 se në nenin 231 paragrafin 6. të ligjit bazik, fshihet fjala “ose 5” te ligji, me datën 27.11.2024, Gjykata mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit: **B. Sh. Xh.**, i lindur më 07.07.1967 në fshatin Godanc i Poshtëm, me vendbanim në fshatin Gllavicë KK Lipjan ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes të dobët ekonomike, i pa martuar, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse më datë 26.10.2023 rreth orës 17.22 min në rrugën Prishtinë ferizja përkatësishtë në fshatin Llapllasellë, është ndaluar i pandehuri gjersa ishte duke e ngarë automjetin e tipit VW Golf me targa të regjistrimit 01-542-JM, me ç’rast pas kërkimit të dokumentacionit të automjetit, është konstatuar se i njëjti ka drejtuar mjetin e lartpërmendur pa patentë shoferi përkatës përkatësisht pa e fituar të drejtën për drejtimin e automjetit.

- me çka ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 231 par. 5 të LRRTRR-së(Ligji nr. 05/L-088) dhe neni 19 të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor(Ligji.nr.06/L-069).

- andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore si dhe neni 35 par.1 të Ligjit për Kundërvajtje.

D Ë N O H E T

ME DËNIM ME TË HOLLA në shumë prej 150 € (njëqind e pesdhjetë euro).

Dënimin e shqiptuar në të holla , ka për t'a paguar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse nuk e paguan në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e ligjit për përmbarim.

I pandehuri, obligohet që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 5 € (pesë euro) në afatin e njëjtë sikurse denimin në të holla në kuptim të nenit 59 dhe 76 të LK-së.

Nga një ekzemplarë i këtij aktgjykimi u dërgohet palëve.

A r s y e t i m i

Stacioni Policor-NJRKR në Prishtinë, kësaj gjykate i ka parashtruar kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse **nr. datë 26.10.2023** kundër të pandehurit të lartëshenuar, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 231. par.5 të LRRTRR, me të cilën ka kërkuar që pranë kësaj gjykate të mbahet shqyrtimi gjyqësor dhe pas administrimit të provave të propozuara, i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari, filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në deklaratën-mbrojtjen e tij, në tërësi pranoi veprën kundërvajtëse e cila i ngarkohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj për këtë nuk pati nevojë që të administrohen prova tjera. Njëherë i ka premtuar gjykatës se nuk do të marrë pjesë më në komunikacion për deri sa nuk kualifikohet për drejtimin e automjetit. Po ashtu ka potencuar se gjendjen ekonomike e ka të vështirë dhe ka kërkuar nga gjykata mundësishtë një dënim ma të lehtë.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklaratës së të pandehurit si dhe kërkesën e stacionit policor, gjyqtari i çështjes erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse të parapara sipas dispozitave të nenit 231 par.1 lidhur me par. 5 të LRRTRR, dhe neni 19 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, gjyqtari mori parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 31 dhe 35 të Ligjit për Kundërvajtje e sidomos peshën e veprës kundërvajtëse dhe pasojat, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, gjendjen e tij personale si dhe atë pasurore, shkallën e përgjegjësisë dhe tiparet personale të tij , pranimin e fajësisë, është penduar dhe ka premtuar se nuk do t'a përsëris mënjë veprim të tillë, andaj bazuar në të gjitha këto rrethana, të pandehurit iu shqiptua një dënim i tillë me bindje se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

GJYKATA-THEMELORE-PRISHTINË-DEGA NË GRAQANICË-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES

K.nr.451/2023 dt. 27.11.2024

Zyrtarja Ligjore
Blerta Bekteshi

Gjyqtari
Rrustem Begolli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtroj ankesë paraqitësi i kërkesës dhe i pandehuri, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit në Gjykatën e Apelit-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.